

A K T I I T H E M E L T M I T

I SHQERISE TREGETARE "MILIFAR" SH.P.K.

Me liqjit nr.7512 date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe privatizimin e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" si dhe ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me vullnetin e tyre te lire 1.NEXHMEDIN MISIRI, 2.ALBERT METANI me zotesi te piote juridike per te vepruar shpallin si vijon :

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare "MILIFAR" sh.p.k. me themelues :
1.NEXHMEDIN MISIRI, 2.ALBERT METANI.

NENI 2

Kjo eshte nje shoqeri me perqjegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te themeluesve ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne L.nr.8, Pall."1 Maji", Shk.2, Ap.51, Tirane. Ajo mund te hape dhe seli te tjera te dyta, dege filiale, perfaqesi si dhe agjenci operative ne te gjithe teritorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj ekonomike ne nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jetet :

- tregetim te barnave veterinare si substancat farmakologjike, preparatet veterinare, bimet mjeksore qe perdoren ne veterinari, disa preparate te mjeksise humane qe perdoren ne veterinari;
- tregetim te materialeve sanitare dhe instrumenteve mjeksore;
- tregetim te materialeve biologjike;
- tregetim te kafsheve (te tokes e te detit, si dhe te shpendeve);
- tregetim te ushqimeve per kafshet, per qellime ushqyese e auksinike, mjekuese e profilaktike;
- tregetim te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore e blegtorale, lende ndertimi, pjese kembimi, etj. me shumice e pakice;
- transport madhrash e udhetaresh urban, interurban e internacional;
- shitje e blerje imobiliare, etj.;
- eksport import te te gjithe mallrave e materialeve.

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke i perbere nga 100 kuota prej 1000 leke sejcila, duke derdhur sejcili ne pjesa te barabarta nga 50%. Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marrin ortaket themelues. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.



NENI 7

Ortaku qe do te shase kuoten e tij teresicht ose pjeserisht duhet
pare te njoftoje ortaket e tjere nepermjet kesiliti i
administrativ te shoqerise. Ortaket e tjere kane te drejten e
parabierjes te cilin duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga dita
e marrjes se njoftimit. Ne rastin e mosushtimit te kesaj te
drejte, ortaku qe do te shesc kuoten duhet te njoftoje emrin e
bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme
se ato qe u jane ofruar ortakeve.

NENI 8

negja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e perjashton ate nga
detyrimet qe kane lindur para largimit te tij. Po ashtu ai fiton
dhe te drejtat qe i jane krijuar para largimit te tij.

NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "MILIFAR sh.p.k. TIRANA,
ALBANIA".

NENI 10

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- asambleja e ortakeve
- administratori
- komisioni i revizionimit

Fusha e veprimit, perberja dne menyra e punes se
organeve drejtuese do te rregullohet me statut.

NENI 11

Administrator i shoqerise "MILIFAR" sh.p.k. eshte z.NEXHMEDIN
MISIRI.

NENI 12

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij
akti themelimi e te statutit i cili formulohet nga asambleja e
nenshkruehet nga administratori si dhe ne perputhje me
ligjeslacionin shqipetar ne fuqi.

NENI 13

Statuti i shoqerise "MILIFAR" sh.p.k. eshte pjesa perberese e
ketij akti themelimi.

NENI 14

Ky akt themelimi perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare
organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e
shoqerise.

ORTAKEV

NEXHMEDIN MISIRI

Nexhmedin Misir

W

ALBERT METANI

Albert Metani

Metani '97

STATUT

I SHOQERISE TREGETARE "MILIFAR" SH.P.K.

Ne baze te ligjit 7512 date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" si dhe te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me vuillnetin e tyre te lire : 1.NEXHMEDIN MISIRI, 2.ALBERT METANI, me zotesi te plete juridike per te vepruar shpallin si vijon:

FORMIMI I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e emertuar "MILIFAR" sh.p.k. me themelues : 1.NEXHMEDIN MISIRI, 2.ALBERT METANI.

FORMA

NENI 2

Shoqeria tregetare "MILIFAR" sh.p.k. eshte shoqeri me perqjegjesi te kufizuar dhe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar.

SELIA E SHOQERISE

NENI 3

Shoqeria tregetare "MILIFAR" sh.p.k. e ka seline e saj ne L.nr.8, Pall."i Maji", Shk.2, Ap.51, Tirane. Ajo mund te hape seli te tjera te dyta, dege filiale, perfaqesi si dhe agjenci operative ne te gjithe territorin e Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 4

Shoqeria tregetare "MILIFAR" sh.p.k. do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj ekonomike ne nje afat te pa caktuar mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te ortakeve.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jetë :

- tregetim te barnave veterinare si substancat farmakologjike, preparatet veterinare, bimet mjeksore qe perdoren ne veterinari, disa preparate te mjeksise humane qe perdoren ne veterinari;
- tregetim te materialeve sanitare dhe instrumenteve mjeksore;
- tregetim te materialeve biologjike;
- tregetim te kafsheve (te tokes e te detit, si dhe te shpendeve);
- tregetim te ushqimeve per kafshet, per qellime ushqyese e auksinike, mjekuese e profilaktike;
- tregetim te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore e blegtoriale, lende ndertimi, pjese kembimi, etj. me shumice e pakice;
- transport madhrash e udhetaresh urban, interurban e internacional;



shitje e blerje imobiliare, etj.;
eksport import te te gjithe mallrave e materialevet.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000 leke i perbere nga 100 kuota prej 1000 leke sejcila, duke derdhur sejcili ne pjesa te berabarta nga 50%. Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marrin ortaket themelues. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 7

Ortaku qe ka ndermend qe te shese kuotat e tij teresisht ose pjeserisht duhet menjehere te njoftoje ortaket e tjere nepermjet keshillit administrativ te shoqerise. Ortaket e tjere kaue te drejten e parablerjes. Kete te drejte ato mund ta ushtrojne brenda 30 diteve nga dita e njoftimit. Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se parablerjes, ortaku qe do shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se ato te ofruara ortakeve te shoqerise.

NENI 8

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejteshme apo te paluejtesime per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 9

Kuotat e kapitalit fillestar jane te derdhura nga cdo ortak ne banke, ne llog.bankare te shoqerise si dhe te rregjistruara ne Librin e liogarise se shoqerise.

NENI 10

Reqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e perjashton ortakun e larguar nga detyrimet qe jane krijuar para largimit te tij.

NENI 11

Gjithashtu ortaku i larguar gezon te gjitha te drejtat qe i kane lindur para largimit te tij.

NENI 12

Shoqeria tregetare "MILIFAR" sh.p.k. eshte perdonuese qe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe mund te shifrytezoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet. Ne Republiken e Shqiperise kjo shoqeri gezon te drejta sicdo person tjeter juridik shqipetar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 13

Shoqeria tregetare "MILIFAR" sh.p.k. vepron ne regjistrin e prones dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kapitalit te saj. Ortaket themelues mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk perpjigjet per detyrimet qe ortaket kane ne pasuri para se te krijohet.



ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 14

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Asambleja e ortakeve
- Administratori
- Komisioni i revizionimit

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohen si me poshtë:

ASAMBLEJA

Asambleja e shoqerise perbehet nga ortaket. Ortaket e shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private me objektet e investuara ne shoqeri. Vendimet qe merr asambleja sipas ligjeve ne fuqi dhe ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithe ortaket e saj. Vendimet e asamblese formulohen dhe firmosen nga administratori. Ajo thirret sa here e shohin te aresyeshme te gjithe ortaket themelues, por detyrimisht per te miratuar programin e veprimtarise se shoqerise per vitin e ardhshem dhe ne Mars per te miratuar bilancin kontabel.

NENI 15

Administratori i shoqerise emerohet z.NEXHMEDIN MISIRI

NENI 16

Shoqeria fiton zotesine e saj per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe ushtron veprimtarine ekonomike me rregjistrimin ne organin perkates tatimor.

NENI 17

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "MILIFAR sh.p.k. TIRANA, ALBANIA".

NENI 18

Asambleja sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike e financiare emeron administratorin dhe puneson persona te ndryshem.

NENI 19

Administratori dhe personi i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjithe fuqine per detyrimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje kufizim. Ata kane mumndesine per te kryer te gjithe aktet qe konsiderojne te pershtatshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte, midis te tjerave, te blejne e te kembejne pasurite qe lidhen me shoqeri te tjera te ngritura brenda dhe jashte vendit duke siguruar pjesmarjen per qellimet e veprimtarise te parashikuar nga neni 5 i ketij statuti. Ata kryejne cdo lloj veprimi prane te gjithe zyrave shteterore e private qe kane te bejne me garancite dhe veprime ipotekore, te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arketime si dhe veprime te tjera qe i sherbejne aktivitetit. Ne keto raste personi i ngarkuar nga administratori eshte i detyruar te njoftoje e t'i jape llogari atij.

NENI 20

DIPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25


Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve do te beje asambleja si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqipetar. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shpendare organeve kopetente si dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te kesaj shoquerie. Statuti i miratuar nga ortaket themelues dhe nenshkruhet nga ata rregullisht.

O R T A K E T

NEXHMEDIN MISIRI

Nexhmedin Misiri


ALBERT METANI

Albert Metani


REPUBLIKA E SHQIPERISE
Noteria Tirane
Nr. 9285 Rep.
Nr. 1732 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 2-12-07 para meje noteres u paragiten personalisht personat 1.NEXHMEDIN MISIRI i biri i Hasanit, i datelindjes 1925, lindur ne Elbasan e banues ne Tirane, 2.ALBERT METANI i biri i Xhemalit, i datelindjes 1962,lindur ne Çorovode e banuaes ne Tirane, te dy me zotesi te plete juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u binda pasi pashe leternjoftimet e tyre, te cilet me vullnetin e tyre te lire nenshkruan para meje dokumentin e mesiperme.

